



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 75

Prishtinë, më 15.4.2013, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi, Behar Selimi, Mufera Shinik, Ardian Gjini, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Gëzim Kelmendi, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj dhe Jasmina Zhivković.

Mungoi: Arsim Bajrami

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati – ZPRK, Artan Canhasi – EULEX, Visar Smajlaj - ekspert, Petrit Hysaj – OSBE, Lejla Selimi – OSBE, Fidan Rama – “Tribuna”, Teuta Gashi – “Kosova Press”, Besnik Ramadani – KDI/TIK, Lirie Berisha – MMPH, Sylë Ahmeti – “Kosova Sot”, Burbuqe Berisha, Mihane Ramadani dhe Gurjeta Zeka – praktikante.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi , kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.3.2013;
3. Shqyrtimi i propozimit të Gjykatës Supreme të Kosovës për riemërimin e anëtarit në Komisionin për kërkesa pronësore;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të pronës;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04-L-177, për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit;
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L- 131, për skemat pensionale të financuara nga shteti;
7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-134, për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari, propozoi që nga rendi i ditës të hiqen pika 4 dhe 6, kurse në pikën të ndryshme të futen :

- Raportet e Komisioneve Kryesore për PL për provimin e Jurisprudencës
- Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Avokatinë

Albulena Haxhiu – Tha se pajtohet që pika 6, skemat pensionale të financuara nga shtetit të hiqet nga rendi i ditës, mirëpo, nuk u pajtua që edhe pika 4, Projektligji për Agjencinë për krahasim dhe verifikim të pronës, të hiqet nga rendi i ditës, sepse mendon që është një Projektligj kriminal dhe kundërkushtetues, dhe se ky Projektligj duhet t'i kthehet Qeverisë.

Behar Selimi – Tha se do të ishte mirë që ky Projektligj të shtyhet për mbledhjen e radhës, duke menduar që të ftohen sponsoruesit e Projektligjit dhe të japin sqarimet lidhur me këtë Projektligj, meqenëse ende nuk e dimë se si ka ardhur deri te ky Projektligj, i cili është kundërkushtetues, duke shtuar se pajtohet që të hiqet nga rendi i ditës pika 4.

Albulena Haxhiu – Theksoi se kishin pasur takime me sponsoruesit, mirëpo, ata nuk kishin njohuri me përmbajtjen e këtij Projektligji. Mendoi se ky Projektligj është i përpiluar nga ndërkombëtarët. Ajo, tha se vendosja e PSBE në fuqi ekzekutive është kundërkushtetues, duke shtuar se Qeveria bisedimet në Bruksel po mundohet ti ndryshojë me Ligj, kur e dinë se ndryshimi bëhet me anë të votave, dhe se marrëveshjet ndërkombëtare duhet të ratifikohen në Kuvend me votim.

Armend Zemaj - Tha se është e pa arsyeshme që po përsëriten gjërat e njëjta. Ai u pajtua me parafolësen që përmes Komisionit për Legjislacioni po tentohet të implementohen marrëveshjet e arritura teknike. Nëse po kërkojmë shpjegime nga ana e sponsoruesit, atë e kemi marrë në seancën plenare dhe tani jemi në një fazë procedurale. Nëse do ta procedojmë në seancën plenare prapë, kam bindjen se do t'i merr votat e mjaftueshme si në leximin e parë.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara nga kryetari kundër heqjes së pikës 4 dhe 6 nga rendi i ditës, ishte Albulena Haxhiu, abstenoj Ardian Gjini.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.3.2013;

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur me 11.3.2013, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozimit të Gjykatës Supreme të Kosovës për riemërimin e anëtarit në Komisionin për kërkesa pronësore

Kryetari – I njoftoi anëtarët e Komisionit për Legjislacion, lidhur me propozimin e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e Adem Vokshit, anëtarë të Komisionit për Kërkesa Pronësore.

Armend Zemaj – Kishte mendim pozitiv për kandidatin Adem Vokshi, ngase ka një CV dhe një përvojë të shkëlqyer. Është hera e tretë që po riemërohet dhe se i plotëson të gjitha kushtet si morale ashtu edhe ato profesionale.

Meqë nuk kishte diskutime të tjera, Komisioni vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të emërohet Adem Vokshi, anëtar i Komisionit për Kërkesa Pronësore

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04-L-177, për Dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit

Kryetari – Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit Funkcional, në Projektligjin për dërgimin e forcës së sigurisë së Kosovës jashtë vendit dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Përfundim

1. Projektligjin nr. 04/L-177, për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t’i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-134, për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi

Kryetari – Tha se në Projektligj dhe në amendamentet e propozuara ka ngatërrim nocionesh dhe mungon lidhja logjike në mes të neneve dhe paragrafëve.

Ai paraqiti vërejtje në amendamentet 5, 9, 14, 15, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 25, 26, dhe propozoi që raporti me amendamente t'i kthehet Komisionit FunkSIONAL.

Ardian Gjini – Duke u ndërlidhur me parafolësin, tha se Komisioni duhet ta ketë mendimin e qartë profesional, lidhur me këtë Projektligj edhe pas amendamentimit të tij. Si Kuvend, shpesh po i përsërisim gabimet e njëjta, lidhur me disa projektligje shumë të rëndësishme, e që nuk janë politike. Ky Projektligj, nuk ka pasur nevojë që të ngatërrohet në koncepte politike sepse ka të bëjë me rregullimin e çështjeve, të cilat duhet të jenë pjesë e konsideratave shumë ma tepër profesionale sesa politike. Po që se ky Projektligj kalon, mendoj se prapë do të kthehet në Kuvend, sepse me këtë Projektligj vetëm sa koklaviten temat. Ky Projektligj duhet t'i kthehet Komisionit FunkSIONAL sepse me të vërtet është ngatërrim serioz.

Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë përfundim:

Përfundim

1. Projektligjin nr. 04/L-134, për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës, në bashkëpronësi dhe amendamentet e propozuara, janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Raporti me amendamentet e propozuara i kthehet Komisionit FunkSIONAL.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara, nuk mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

8. Të ndryshme

a) Raportet e Komisioneve Kryesore për Projektligjin për provimin e Jurisprudencës

Kryetari – E njoftoi para Komisionit se në raportet e Komisioneve kryesore nuk ka ndonjë vërejtje në Projektligjin për Provimin e Jurisprudencës dhe në amendamente.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

- I. *Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit Kryesor në Projektligjin për provimin e Jurisprudencës.*
- II. *I rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i Projektligjit me amendamentet e propozuara nga Komisioni.*

III. Amendamentet e propozuara janë paraqitur si aneks i këtij procesverbali.

b) Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Avokatinë

Komisioni e shqyrtoi në parim Projektligjin për Avokatinë, dhe vlerësoi se Projektligji ka bazë kushtetuese. Në aspektin përmbajtjesor, i plotëson kushtet e përcaktuara me rregullat e hartimit të legjislacionit, si dhe kushtet e caktuara me Rregulloren e Kuvendit, për t'u proceduar për shqyrtim dhe për miratim në parim, prandaj, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet në parim, Projektligji nr. 04/L-193, për Avokatinë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:05
E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi